



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Datë 28/04/2026

PROCESVERBAL

Konsultimi Publik për Planin Strategjik Vendor për Rininë 2026-2029 Bashkia Përmet

Vendi : Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Përmet

Ora : 13:30

Tema e konsultimit : Plani Strategjik Vendor për Rininë 2026-2029

I mbajtur sot më datë 28 Prill në ambientet e sallës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Përmet. Të pranishëm në këtë takim janë Drejtoresha e Projekteve dhe Integritetit Europian znj. Klaudja Ciko, Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik znj. Etleva Myftari, përfaqësues të shkollave të qytetit dhe ZVA Përmet, të rinj anëtarë të Këshillit Rinor dhe jo vetëm.

Takimi u hap nga znj. Myftari e cila theksoi edhe një herë rëndësinë e këtij plani lidhur me një të ardhme sa më të mirë dhe cilësorë të të rinjve të qytetit dhe zonave përreth. Gjithashtu ajo u shpreh e hapur për të prituri ide dhe sugjerime nga të gjithë pjesëmarrësit të cilat mund ti dërgojnë pranë zyrave të Bashkisë Përmet ose në faqen zyrtare online.

Më pas fjalën e mori znj. Ciko e cila do të bëjë edhe prezantimin e këtij plani në mënyrë më të detajuar. Ajo tha se ky plan përveç se është një detyrim ligjor, ka një rëndësi të vecantë për ceshtjet rinore duke theksuar edhe një herë nevojën për hartimin e tij. Gjithashtu ajo u tregoi të pranishmëve se janë zhvilluar një sërë takimesh përpara hartimit final të këtij plani duke u konsultuar më të gjithë aktorët e përfshirë si dhe duke marrë nga ta rekomandime të shumta.

Në vijim të fjalës së saj znj. Ciko tregoi gjithashtu se ky plan është mbështetur tek Strategjia Kombëtare e Rinisë si një dokument thelbësor në çështjet e rinisë. Pasi bëri prezantimin e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

të gjithë planit, ajo u shpreh e hapur për të dëgjuar sugjerimet e të pranishmëve. Gjithashtu të dyja drejtueset u thanë edhe një herë të rinjve se Këshilli Rinor duhet të jetë më i pranishëm në vendimmarjet e Këshillit Bashkiak duke i dhënë kështu një zë më të fortë të rinjve.

Takimi u mbyll në orën **14:10**.

Konceptoi:

Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Denisa DURRO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Foto nga takimi:

